



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1977
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 02.06.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 18

Datë: 28.05.2025

“ Për miratimin e rrugës automobilistike Vinjoll-Selishtë.”

(Nga Vinjoll deri në kufirin administrative të Bashkisë Dibër)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Kopje
02-06-2025



1977/03/06/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.434/1 prot.

Peshkopi, më 02.06.2025


Lënda: Për vendimin nr.18, datë 28.05.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.18, datë 28.05.2025 “**Për miratimin e rrugës automobilistike Vinjoll-Selishtë**”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 18 Datë 28/05/2025

**“ Për miratimin e rrugës automobilistike në Vinjoll-Selishtë”
(Nga Vinjoll deri në kufirin administrativ të Bashkisë Dibër)**

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 14, nenit 54 dhe nenit 55 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, relacionit të pregatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve Komunitare, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **28.05.2025**, me 17 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e rrugës lidhëse automobilistike Vinjoll-Selishtë, nga fshati Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat, Njësia Administrative Selishtë, Bashkia Dibër (kufiri midis dy Njësive Administrative). Rrugë e cila nga fshati Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat deri në kufirin e Bashkisë Dibër është me gjatësi 1.5 km në territorin e Bashkisë Mat, sipas gjurmës së përcaktuar në hartën bashkëlidhur, dhe shtrihet në ekonominë pyjore Balgjaj 1, e cila është në inventarin e Bashkisë Dibër, transferuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve Komunitare, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **28.05.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

PRPJEKT VENDIM

Nr. 01 Datë 25 . 04 . 2025

"Për miratimin e rrugës automobilistike në Vinjoll-Selishtë"

(nga Vinjolli deri në kufirin administrativ të Bashkisë Dibër)

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "a" dhe nënpika 1.2 shkronjat "a" dhe "c", nenit 23 pika 14, nenit 54 dhe nenit 55 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisje Vendore", nenet 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtëshme të shtetit", të ndryshuar, relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve Komunitare, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËRKOJMË :

1. "Miratimin e rrugës lidhese automobilistike Vinjoll-Selishtë", nga fshati Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat deri në fshatin Qafmurrë, Njësia Administrative Selishtë, Bashkia Dibër (kufiri midis dy Njësive Administrative). Rrugë e cila nga fshati Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat deri në kufirin e Bashkisë Dibër është me gjatësi 1.5 km në territorin e Bashkisë Mat sipas gjurmës së rrugës të përcaktuar në hartën bashkëlidhur Projekt Vendimit dhe shtrihet në ekonominë pyjore Balgjaj 1, e cila është në inventarin e Bashkisë Dibër, transferuar me VKM nr. 433 datë 08.06.2016.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti Qarkut Dibër.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve Komunitare, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike.

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit
të Territorit, Mjedisit dhe Pronës

Drejtor
Elvis Manga




Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve

Drejtor
Agron Cara



Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Kryeinspektor
Afrim Mikli



Drejtoria Juridike

Drejtor
Ismet Saraci




KRYETARI I BASHKISË

Rahim Spahiu

Në mnugesë e me porosi

Zëv.Kryetar

Lorenç Gëbaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

Peshkopi më 2025

RELACION

“Për miratimin e rrugës automobilistike Selishtë - Qafë Murrë - Vinjoll”

(në kufirin administrativ të Bashkisë Dibër)

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Dibër.

Të nderuar këshilltar !

Bazuar në kërkesat e vazhdueshme të banorëve të fshatrave Qafë Murrë dhe Selishtë, të cilët ndër vite kanë kërkuar hapjen e trashes së rrugës në drejtim të fshatit Vinjoll të bashkisë Mat për arsye të shkurtimit të distancës midis fshatrave Selishtë dhe Qafë Murrë, Njësia Administrative Selishtë, Bashkia Dibër me fshatin Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat, me qëllim lidhjen e dy bashkive, Bashkisë Dibër dhe Bashkisë Mat, dhe lëvizjen e banorëve në mënyrë më të shpejtë dhe me më pak kosto, Bashkia Dibër kërkon të rehabilitojë këtë aks rrugor.

Nga verifikimi në terren ka rezultuar se rruga që lidh fshatrat Qafë Murrë dhe Selishtë, Njësia Administrative Selishtë, Bashkia Dibër me fshatin Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat është rrugë ekzistuese, por në shumë vende ka nevojë për zgjerim trasheje dhe riparime në mënyrë që të bëhet funksionale për automjete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe krahasimi me sistemin Asig - Geoportal rezulton se rruga ekzistuese që kërkohet të zgjerohet nga fshati Selishtë, Njësia Administrative Selishtë, Bashkia Dibër me fshatin Vinjoll, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat (kufiri midis dy Njësive Administrative) shtrihet në ngastrat e ekonomive pyjore Zhuri i Pllaut Qafë Murrë, pjesa ekonomike Qafë Murrë, Kacni dhe Prat Bufull, pjesa ekonomike Prat e cila është në inventarin e Bashkisë Dibër, transferuar me VKM nr. 433 datë 08.06.2016.

Të ndodhur në këto kushte, duke u bazuar në kërkesat e vazhdueshme të banorëve të fshatrave Qafë Murrë dhe Selishtë si dhe në dokumentacionin tekniko-ligjor rezulton se pasuria që preket nga miratimi për hapjen e kesaj rruge janë ngastrat e ekonomive pyjore Zhuri i Pllaut Qafë Murrë, pjesa ekonomike Qafë Murrë, Kacni dhe Prat Bufull, pjesa ekonomike Prat të cilat janë në inventarin e Bashkisë Dibër, transferuar me VKM nr. 433 datë 08.06.2016.

Për sa më sipër ju paraqesim të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, për një vendimarrje të drejtë dhe ligjore që rruga nga fshati Selishtë - Qafë Murrë, Njësia Administrative Selishtë Bashkia Dibër me fshatin Vinjoll, Njësia Administrative Lis,, Bashkia Mat (*kufiri midis dy Njësive Administrative*) që shtrihet në territorin e Bashkisë Dibër që bën të mundur lidhjen e Bashkisë Dibër me Bashkinë Mat në një distancë shumë të shkurtër, të miratohet sipas gjurmës së rrugës të përcaktuar në hartën bashkë lidhur Projekt Vendimit.

Faleminderit !


Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit
të Territorit, Mjedisit dhe Pronës

Drejtor
Elvis Manga




Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave

Drejtor
Agron Cara



Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
Kryeinspektor

Afrim Mikli



Drejtoria Juridike

Drejtor
Ismet Saraçi



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Me Urdhër dhe Porosi

ZV. KRYETARI

Edorenc CIBAKU

